



Kalendari Yeter

2024

01

Landfilli i Bajkajt, shërbimi kryesor për 5 Bashki jugore në qarkun tonë, po përmirësohet! Me tarifën e re, investojmë në cilësi dhe mbulim të kostove për një mjedis të qëndrueshëm.
Faleminderit Bashkive të qarkut dhe këshilltarëve për mbështetjen!

M	T	W	T	F	S	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				



Bramyshnje - Tërbaç
Përkujtohet 80-vjetori i krijimit të Brigadës së V Sulmuese "Hero i Popullit".
Së bashku me autoritetet e tjera qendrore dhe vendore, Kryeta i Qarkut Vlorë, Ervis Moçka vendosi kurora me lule në memorialin kushtuar Brigadës së V Sulmuese "Hero i Popullit".



Sot shënohet 105 vjetori i ndarjes nga jeta të Ismail Qemalit, babait të pavarësisë së Shqipërisë.
Në këtë ditë të rëndësishme, le të kujtojmë dhe nderojmë trashëgiminë e tij të jashtëzakonshme dhe kontributin në liri dhe pavarësi.



Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë, Ervis Moçka dhe Kryetari i Bashkisë Selenicë, Nertil Bellaj kanë vizituar ambjentet e kopshtit "Stavri Bombaj" në Selenicë, të rikonstruktura totalisht falë një investimi të Këshillit të Qarkut Vlorë.



Shoqata e Qarqeve të Shqipërisë u përfaqësua sot nga Kryetari I Qarkut Vlorë Ervis Moçka në takimin e parë të Grupit të punës për zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve dhe të zgjedhurve vendorë.

Ervis Moçka

02

M	T	W	T	F	S	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29			



Delegacioni nga Vlora, i përbërë nga Kryetari i Qarkut Ervis Moçka dhe Kryetarët e Bashkive Vlorë dhe Selenicë, bashkohet me festimet e Pavarësisë së Kosovës në Mitrovicë.



Përkujtohet 81-vjetori i çetës Çamëria, duke nderuar heroizmin dhe guximin e shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Shkurt

03

M	T	W	T	F	S	S
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31


Prezantohet Dokumenti Strategjik për Zhvillimin Ekonomik të Qarkut të Vlorës - "Vlora 2030"!

Në një takim zhvilluar ditën e sotshme pranë ambjentëve të Këshillit të Qarkut Vlorë, dhe me praninë e Kryetarit të Qarkut Ervis Moçka, Kryetarit të Bashkisë Vlorë z. Ermal Dredha, Këshilltarit të Rajonit Puglias për zhvillimin ekonomik z. Alessandro Delli Noci, Konsulles së përgjithshme të Italisë në Vlorë znj. Iva Palmieri dhe autoriteteve e grupeve të interesit, është prezantuar nga ekspertë italianë dhe shqiptarë puna 2 vjeçare e finalizuar në një dokument strategjik.

Ky plan strategjik, i financuar nga Agjensia italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe përgatitur me përkushtim dhe bashkëpunim me Bashkitë e Vlorës dhe Himarës, si dhe partnerët tanë të vlerësuar nga Rajoni i Puglias, është një hap i rëndësishëm drejt një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm për Qarkun e Vlorës.

Dokumenti "Vlora 2030" ofron një vështrim të qartë për mundësitë dhe potencialet e sektorëve të turizmit dhe bujqësisë, duke hapur rrugën për zhvillim në të gjitha nivelet.

Sot kemi një strategji thelbësore dhe hapa konkrete të cilat do të shërbejnë si udhërrëfyes për të 7 Bashkitë e Qarkut Vlorë.



Në ambjentet e Bashkisë Delvinë u organizua mbledhja e radhës e Këshillit të Qarkut Vlorë.

Falenderime shkojnë për Kryetarin e Bashkisë Delvinë z.Besmir Veli për mikpritjen e tij dhe gjithë Këshilltarët e pranishëm që unanimisht miratuan P/V e radhës të përcaktuara në Rend Dite. Mes të tjerash u diskutuan disa projekte për qytetin e Delvinës, Konispolit dhe Finiqit ku rëndësi do ti jepet; infrastrukturës, rikonstruksioneve si dhe aktiviteteve kulturore



Kryetari i Qarkut z. Ervis Moçka mirëpriti pranë ambjentëve të Këshillit të Qarkut Vlorë, Shkëlqesinë e tij z. Stefano Palmieri - Ambasadori i Urdhrit Sovran të Maltës, shoqëruar nga Konsullja e Përgjithshme e Italisë në Vlorë znj. Iva Palmieri. Gjatë bisedës miqësore u diskutua mbi mundësinë e bashkëpunimit në aktivitete dhe projekte humanitare në qarkun e Vlorës



Mars

04

Në ambjentet e Këshillit të Qarkut Vlorë në vazhden e takimeve Kryetari i Këshillit z. Ervis Moçka mirëpriti përfaqësinë e Shoqatës " Laskarina Bubulina"- "Gratë e Detarëve Shqiptarë-GDSH".-Mbështetjen e femrave me ndikim në mirëqenien, zhvillimin dhe emancipimin e grave dhe vajzave të detarëve dhe komunitetit ku ato jetojnë.

-Njohjen, evidentimin dhe propagandimin e traditave lundrimore, tregtare dhe luftarake të popullit shqiptar në fushën e detarisë.

-Propagandimin e traditave dhe figurave të shquara të detarisë shqiptare në shekuj.

-Nxitjen e iniciativës për përfshirje sa më të gjerë të grave, vajzave dhe familjeve të detarëve në veprimtaritë që kanë lidhje me fushën detare.



Kryetari i Këshillit të Qarkut z. Ervis Moçka është ftuar të marr pjesë në aktivitetin e zhvilluar në kuadër të "Ditës Ndërkombëtare të Popullit ROM " aktivitetet realizuar nga Shoqata Atdhetare-Kulturore "Shqipëria".

"Java Rome", në një aktivitet të veçantë për të festuar historinë,kulturën, si dhe për të diskutuar mbi sfidat e komunitetit Rom.

Në një kohë kur toleranca dhe respekti për diversitetin janë sfidat themelore të çdo shoqërie, është e rëndësishme që të gjithë bashkë ,përfaqësues të pushtetit lokal, institucionet qendrore, shoqëria civile dhe përfaqësues të këtij komuniteti, të bashkohen dhe të ndërtojnë ura të forta të bashkëpunimit dhe solidaritetit.

Prill

05



Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë z. Ervis Moçka së bashku me autoritetet e tjera qendrore e vendore kanë nderuar e kujtuar ditën e sotme Dëshmorët e Kombit.

Data 5 Maj! Dita e heronjëve!

Janë të shumtë emrat e të gjitha kohërave që kujtohen me mirënjohje jo vetëm për vlerat e përjetëshme dhe kontributin që dhanë për çlirimin e vëndit për një të ardhme më të mirë, por edhe të gjithë ata që sakrifikuan jetën e tyre për liri, demokraci, të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e çdo shqiptari.

M	T	W	T	F	S	S
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		



Për dy ditë rradhazi, më 17 & 18 Maj Konispoli është kthyer në skenën e madhe të folkut autentik shqiptar. Bashkia Konispol me mbështetjen e Këshillit të Qarkut Vlorë organizoi aktivitetin Fest Folk 2024 "Sofra Konispolate". Ky festival mblodhi rreth vetes grupe folklorike të cilat plotësuan tablonë e madhe e të larmishme të këngëve dhe valleve shqiptare, me qëllim promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të zonës.

Maj

17-18 MAJ 2024

06

Nga Myftinia Vlorë, urojmë të gjithë besimtarët myslimanë
një festë të lumtur dhe të mbushur me dashuri dhe harmoni.
Gëzuar Kurban Bajramin!

M	T	W	T	F	S	S
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30

Sot në Kuç, në një ceremoni festive u përkujtua 80-vjetori i Çlirimit të Krahinës së Kurveleshit, me pjesmarrjen e autoriteteve të pushtetit qendror dhe vendor, shoqatava patriotike - atdhetare dhe banorëve të zonës.

Një ngjarje e rëndësishme që na kujton sakrificat dhe trimërinë e paraardhësve tanë.

Lavdi heronjve që luftuan për lirinë e këtij vendi!



Pershë

07

Një ngjarje e jashtëzakonshme muzike klasike u zhvillua mes peizazhit mahnitës të fshatit Vuno! Nga 26-28 Korrik, tingujt e muzikës klasike mbushën ambientet përreth Kishës së Shën Spiridhonit, duke sjellë emocione të papërshkrueshme.

Organizuar nga Bashkia Himarë, Këshilli i Qarkut Vlorë dhe me mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ky festival u kthye në një festë për dashamirësit e muzikës klasike.

Atmosfera magjike e Vuno-it dhe performanca e jashtëzakonshme e artistëve vendas e të huaj, krijuan një përvojë të paharrueshme.

Le të vazhdojmë të mbështesim kulturën dhe artin!



Korrik

M	T	W	T	F	S	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28

08

09-10 Gusht - "Traditë, Kulturë, Shije Delvinjote"

Bashkia Delvinë Këshilli i Qarkut Vlorë

PANAIRI

"TRADITË, KULTURË,

M	T	W	T	F	S	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

08-09-10 Gusht në Kotë

Bashkia Selenicë me mbështetjen e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe DrKK, në kuadër të aktiviteteve si pjesë e axhendës kulturore starton ditën e sotme edicionin e 2-të "Festivalit Folklorik të Zonës".

Aktiviteti ka për qëllim ruajtjen dhe trashëgimin e vlerave kulturore dhe shpirtërore të zonës në të njëjtën kohë promovim turistik e natyror të kësaj treve.



Gusht

09

M	T	W	T	F	S	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30						





Në ambjentet e Bibliotekës së Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës u promovuan ditën e sotme tre veprat e autorit Ago Nezha. Autori dallon për veprimtarinë e tij të dendur e cilësore dhe si veprimtar i spikatur shoqëror, ai sot mban titujt e nderit “Mjeshtër i Madh”, “Personalitet i Shquar i Labërisë”, “Personalitet i Shquar i Qarkut të Vlorës”. Autori trajton problemet të cilat kanë të bëjnë me shqetësimet që ka shoqëria jonë, shqetësimet e vendit tonë në postdemokraci. Ai bënë vlersimin e të kaluarës, duke parë të sotmen dhe mendon për të ardhmen sesi do të jetë. Jep një pasqyrim të realitetit e shprehur kjo në veprimtarinë shoqërore dhe ekonomike të vendit.

Shkator

10

Prezantimi i Qarkut të Vlorës në Asamblenë e Përgjithshme të CPMR!

Gjatë prezantimit të Qarkut të Vlorës si anëtar i ri i Konferencës së Rajoneve Periferike dhe Detare (CPMR), u theksua potenciali i madh i rajonit tonë për të bashkëpunuar në projekte evropiane, sidomos në fushat e turizmit të qëndrueshëm dhe zhvillimit ekonomik. Rajoni Vlorës, me një shtrirje të gjatë bregdetare, mbetet një pikë strategjike për zhvillimin rajonal në Mesdhe.



M	T	W	T	F	S	S
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			



#CPMRIslands
#CPMRBalticSea

Në kuadër të aktiviteteve që Këshilli i Qarkut Vlorë ka ndërmarr me nismën e grave Këshilltare të Këshillit të Qarkut, vazhdojmë me takimet organizuar pikërisht për "Tetorin Rozë".

Aktiviteti i radhës do të zhvillohet në Sarandë, ditën e Shtunë, dt: 26/10/2024, Ora 10:30.

Rëndësia e këtyre takimeve konsiston në ngritjen e vetëdijes mbi kancerin e gjirit, informimin, parandalimin e diagnostikimin e hershëm dhe mbështetje për gratë që preken nga kjo sëmundje.

Aktivitetet e organizuara në këtë periudhë inkurajojnë diskutime, ndihmojnë në shkatërrimin e stigmatizimit dhe përforcojnë rëndësinë e kontrollit të rregullt shëndetësor.

Tetor

11

Gëzuar 29 Nëntorin – Ditën e Çlirimit!

Çlirimi i Shqipërisë është më shumë se një ngjarje historike; është një kujtim i fuqisë së popullit shqiptar, që luftoi dhe u bashkua për një të ardhme më të mirë.

Kjo ditë na kujton se, pavarësisht vështirësive, shpresa dhe besimi në liri kanë qenë gjithmonë motorët që na kanë shtyrë përpara.

Le të festojmë këtë ditë me respekt dhe mirënjohje për ata që bënë të mundur këtë moment të paharrueshëm.

Lavdi Dëshmorëve të Atdheut!

#80-vjetoriiÇlirimit!



M	T	W	T	F	S	S
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	

Nën Hijen e Ullinjve” - Takimi i Orkestrinave Popullore

Këshilli i Qarkut Vlorë ka kënaqësinë të organizojë një mbrëmje të veçantë muzikore me titullin “Nën Hijen e Ullinjve,” ku do të bashkohen grupet muzikore nga Vlora, Saranda, Konispoli Finiqi dhe Delvina.

Ju ftojmë të na bashkoheni ditën e Martë, më 29 Tetor, ora 18:00, në Pallatin e Kulturës, Salla e Kinemasë, për të festuar bukurinë e muzikës popullore qytetare, një trashëgimi kulturore që na bashkon dhe na lidh thellësisht me rrënjët tona.

Nëntor

12

M	T	W	T	F	S	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					



Nga Kisha e Shën Theodhorit, përcojllëm urimet tona për një Krishtlindje të mbushur me paqe, dashuri dhe harmoni për të gjithë besimtarët e krishterë.
Gëzuar Krishtlindjet!

Në Këshillin Konsultativ, një platformë e rëndësishme dialogu mes vetëqeverisjes vendore dhe qeverisë qendrore



Dhjetor

A serene sunset scene over a calm body of water. The sun is low on the horizon, casting a bright, shimmering reflection across the water's surface. The sky is a mix of soft orange and pale yellow, with wispy clouds. In the distance, silhouettes of mountains are visible against the horizon. On the right side of the frame, the dark, silhouetted branches of a tree hang down, adding a sense of depth and framing to the scene.

Bye bye 2024

Welcome 2025